VENDIM
Nr. 675, datë 10.11.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM PËR QYTETIN E ROSKOVECIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 971 548.50 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 971 548.50 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Roskovec.
8. Bashkia Roskovec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Roskovec, fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Roskovec.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Roskovec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
"PËRMIRËSIMI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM PËR QYTETIN E ROSKOVECIT"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Nr. i pasurisë	ZK	Sipërfaqja e parcelës, sipas kartelës së pronësisë m²	Sip. e tokës e prekur m²	Çmimi, lek/m²	Vlera e tokës	Lloji i kulturës bujqësore	Vlera e kulturës/dy	Vlera në lek e kulturës	Vlera totale, lek	Shënime sqaruese
1	Defrim Barjam Hoxha	63/36	3767	4,759.00	1,074.00	269	288,906.00	Misër	17,125.00	18,392.25	307,298.25	**Certifikatë pronësie**
2	Hekuran Bajram Mamo	64/27	3767	3,257.00	1,074.00	269	288,906.00	Misër	17,125.00	18,392.25	307,298.25	**Certifikatë pronësie**
3	Aqif Caush Hoxha Emine Shaip Hoxha	66/4	3767	5,455.00	1,284.00	269	345,396.00	Tërfil	9,000.00	11,556.00	356,952.00	**Certifikatë pronësie**
Vlera totale paraprake					**3,432.00**		**923,208.00**			**48,340.50**	**971,548.50**	

1. Vlerësimi për kulturën bujqësore është kryer bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000
2. Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë arë", është kryer në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.